

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Emine Mustafa kryetare e kolegjit, Nebojša Borčić dhe Avdi Dinaj anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurve N. M., H. L. dhe A. F. për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shitja dhe shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.3 dhe 2 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.1 dhe 1.9 të KPK, veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, duke vendosur lidhur me kërkesën e përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të pandehurit H. L., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PPRKR.nr.545/15 të datës 18.03.2016 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.499/2016 të datës 25.03.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.04.2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të pandehurit H. L., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PPRKR.nr.545/15 të datës 18.03.2016 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.499/2016 të datës 25.03.2016.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PKR.nr.133/15 të datës 01.02.2016, të pandehurve N. M. dhe H. L., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shitja dhe shpërndarja e paautorizuar e

narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.3 dhe 2 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.1 dhe 1.9 të KPK, veprën penale importi, eksporti, furnizimi, transporti, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse nga neni 372 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, ka vazhduar masën e paraburgimit në edhe për 2 (dy) muaj e cila do të llogaritet nga data 18.03.2016 deri me 18.05.2016, ndërsa të pandehurit A. F. për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale të lartëcekura, ia ka vazhduar masën e arrestit shtëpiak në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj e cila do të llogaritet nga data 18.03.2016 deri me 18.05.2016. Masa e paraburgimit dhe e arrestit shtëpiak është vazhduar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1, 1.2.2, 1.2.3 të KPPK-së.

#### *Vendimi i Gjykatës së Apelit*

Kundër këtij aktvendimi ankesë kanë paraqitur mbrojtësit të pandehurit H. L., mirëpo Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN1.nr.499/2016 të datës 25.03.2016, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën dhe e ka vërtetuar aktvendimin e ankimuar.

#### *Paraqitësi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe pretendimet e tij.*

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë të përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar mbrojtësit të pandehurit H. L. av. B. J., A. J. dhe V. H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta prish aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ate të shkallës së dytë dhe masën e paraburgimit ta zëvendësojë me masën e dorëzarisë ose me paraqitjen në stacionin policor.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësit kryesisht theksojnë se aktvendimet e atakuara kanë bërë shkelje në kuptim të nenit 187 par.1 nënpar.1.1 pika 1.2.1, 1.2.2, 1.2.3 të KPPK, duke mos artikuluar dhe provuar faktet rreth dyshimit të bazuar ndaj të pandehurit H. L., se Gjykata e Apelit asnjëherë nuk mori parasysh gadishmërinë e familjarëve të pandehurit për pagimin e dorëzarisë në shumën që do ta përcaktojë Gjykata, apo të caktojë masën alternative paraqitjen në stacionin policor, se pretendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe ate të shkallës

së dytë lidhur me ekzistimin e dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprat penale janë hipotetike sepse tek i pandehuri nuk është gjetë asnjë substancë e ndaluar psikotropike dhe asnjë municion apo materie plasëse.

*Opinionimi i Prokurorit të Shtetit lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.*

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.29/16 të datës 22.01.2016, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të pandehurit H. L. të refuzohet si e pabazuar.

*Gjetjet e Gjykatës Supreme*

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesave, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo juridike, kryesisht nga provat që gjenden në shkresat e lëndës si: sasia e narkotikëve në peshë prej 41 kg e 908 gramë, municioni pre 2717 fishekëve të kalibrave të ndryshëm, procesverbalet mbi marrjen në pyetje të pandehurve të dhëna në polici, kallëzimi penal nr.2015-DHTN-265 të datës 19.12.2015, transkriptet e përgjimit të telefonave, si dhe provat tjera të mbledhura gjerr më tani rezulton se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri është kryerës i veprave penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187 par.1 nën par.1.1 të KPPK për vazhdimin e paraburgimit, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale.

Kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.1 të KPPK ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale duke pasur parasysh faktin se i pandehuri është shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe se këto vepra penale janë të natyrës së rëndë, e nëse i pandehuri shpallet fajtor, parashihen dënime mjaft të larta, ashtu që në

këtë mënyrë do të ishte i paaritshëm për organet e ndjekjes dhe do ta pamundësonte zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.2 të KPPK-së, sepse po të gjendej i pandehuri në liri ekziston rreziku i asgjësimit, fshehjes apo ndryshimit të provave të veprës penale, ndikimit në dëshmitarët eventual, përkatësisht nga kallëzimi penal rezulton se në bazë të informacioneve të policisë dhe në bazë të transkripteve të përgjimit të telefonave në këtë çështje penale janë të përfshirë edhe persona të tjerë, apo ndikimit në të pandehurit tjerë me qëllim të favorizimit të ndonjërit në procedurën penale, duke pas parasysh se hetimet ende nuk kanë përfunduar.

Gjithashtu kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit edhe konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së duke pasur parasysh karakteristikat personale të pandehurit, peshën e rëndë të veprës penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale, rrethanat dhe ambientin në të cilat është kryer vepra penale, lë të besohet se me lëshuarjen e të akuzuarit në liri mund të vijë deri te përsëritja e veprës penale për shkak të rethanave të acaruarra në mes të akuzuarve.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.108/16 datë 25.04.02.2016.

B.profesionale,  
Mirlinda Mejzini

Kryetare e kolegjit,  
Emine Mustafa